



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LUELA V. GERMENJI
ADRESA NR.7, MUHAMED
GJOLLESHA, NR.73/1
TEL: 689075742

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1689

Nr. koleksioni: 821

Tirane më 20/12/2023

12

Digitally signed by LUELA
GERMENJI

- Ligjet referuese:
- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
 - 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
 - 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023050700083488764



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "ISOMETRIC" SH.P.K)**

Sot, më datë 20/12/2023, para meje Notere **LUELA V. GËRMENJI**, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANË, NR.7, Rr. "MUHAMET GJOLLESHA", NR.73/1, u paraqitën personalisht:

S H I T Ë S: Znj. Rozalina Bardhoci, atësia Safet, amësia Mira, shtetase Shqiptare, lindur në Kukës dhe banuese në TIRANË, me adresë Agron Jano; Nd. 27; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 07/10/1997, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID Nr. [redacted] dhe Nr. personal [redacted]. Ortak në shoqërinë "ISOMETRIC" sh.p.k që zotëron 1 kuotë me vlerë 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "ISOMETRIC" sh.p.k të regjistruar, në këtë kontratë do të referohet si "Shitësi"

B L E R Ë S: Z. Nadiel Çadri, atësia Ramazan, amësia Tatjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. "Odhise Grillo"; Nd. 54; H. 2; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 25/08/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. [redacted] dhe Nr. personal [redacted]. Ortak në shoqërinë "ISOMETRIC" sh.p.k që zotëron 1 kuotë me vlerë 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "ISOMETRIC" sh.p.k të regjistruar, në këtë kontratë do të referohet si "Blerësi".

Meqënëse, Shitësi dëshiron të shesi pjesën e tij të kuotës që zotëron të kapitalit të rregjistruar të Shoqërisë "ISOMETRIC" sh.p.k dhe blerësi ka shprehur dëshirën për të blerë këtë kuotën që zotëron Shitësi.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "ISOMETRIC" Sh.p.k, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

1.1 Sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë, Shitësi Znj. Rozalina Bardhoci, Ortak i shoqërisë "ISOMETRIC" sh.p.k që zotëron 1 kuotë me vlerë 40 % (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "ISOMETRIC" Sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me Nipt (NUIS) L 92207009 A, me seli në Tiranë, Rruga Vaso Pasha, Nr. 3, B.1, dëshiron të shesë, të transferojë dhe dorëzojë 1 kuotë me vlerë 40 % (dyzet përqind) të kapitalit themeltar që ajo zotëron në Shoqërinë "ISOMETRIC" Sh.p.k, të lirë nga lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili pranon dhe blen sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë kontratë.

NENI 2

BAZA LIGJORE

- 2.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 2.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 2.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

NENI 3

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

3.1 Çmimi i shitblerjes së kuotës në kapitalin e regjistruar, objekt i kësaj Kontrate është si më poshtë:

Shitësi Znj. Rozalina Bardhoci, Ortaku i Shoqërisë "ISOMETRIC" Sh.p.k, shet në favor të Blerësit, Z. Nadiel Çadri, Ortaku i Shoqërisë "ISOMETRIC" Sh.p.k, 1 kuotë me vlerë 40 % (dyzet përqind) të kapitalit themeltar që ajo zotëron në Shoqërinë "ISOMETRIC" Sh.p.k, në vlerën totale 1.720.000 Lekë (Një milion e shtatëqind e njëzet mijë) Lekë.



A2023050700002213328

3.2 Pagesa e çmimit të shitjes do të kryhet nga ana e Blerësit Z. Nadiel Çadri, deri me datë 01.02.2024, kjo e vërtetuar sipas mandat pagesave bashkalidhur, kësaj Kontrate..

NENI 4

Detyrimet dhe Garancitë Palëve

4.1 Shitësit me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Blerësin se:

- (i) Nuk janë palë në ndonjë kontratë ose marrëveshje të shkruar ose gojore me anë të së cilës të krijohen të drejta pronësie, të drejta votimi apo çdo lloj e drejte tjetër mbi kuotën e kapitalit objekt shitje sipas kësaj Kontrate, në favor të ndonjë pale të tretë;
- (ii) Kuota e kapitalit që shiten në favor të Blerësit nëpërmjet kësaj Kontrate janë të lira nga çdo barrë, interes apo pretendim i ndonjë personi të tretë të çfarëdo lloji dhe nuk janë vënë nga Shoqëria apo nga Shitësit bashkarisht ose veç e veç si garanci në favor/ose për shlyerjen e detyrimit apo të detyrimeve të ndonjë personi të tretë.
- (iii) Kjo kontratë do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj palëve, trashëgimtarëve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt, (duke mos patur asnjë pretendim qoftë dhe gjyqësisht as tani dhe as në të ardhmen. Me nënshkrimin e kësaj kontrate deklarojnë dhe garantojnë dhe në emër të trashëgimtarëve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt nuk do të ngrejnë pretendime mbi shitjen e këtyre kuotave as tani dhe as në të ardhmen dhe nuk do ti kërkojnë ato qoftë dhe gjyqësisht.)
- (iv) Kjo kontratë përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm dhe të ekzekutueshëm për shitësin dhe për blerësin.
- (v) Palët deklarojnë se me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk do të kenë detyrime të ndërsjellta ndërmjet njëri tjetrit përveç likuidimit të çmimit të shitjes së kuotëve.

NENI 5

Shpenzimet dhe Taksat

5.1 Shpenzimet ligjore, shpenzimet noteriale, tarifrat e rregjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër administrative që lidhet me këtë kontratë, rregjistrimin e saj në QKB do të jenë në ngarkim të Blerësit.

NENI 6

Ligji i Zbatueshëm

- 6.1 Problemet në lidhje me çështjet që mund të lindin sipas kësaj Kontrate por që nuk janë parashikuar në të, do të zgjidhen në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, të cilët do të jenë të zbatueshme në këtë kontratë.
- 6.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis palëve këtu në lidhje me këtë Kontratë dhe që nuk do të zgjidhet nga negociatat midis tyre, do të jetë objekt vendimi i Gjykatës kompetente.
- 6.3 Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni Shqiptarë në fuqi dhe shpreh vullnetin e palëve.

NENI 7

Të ndryshme

- 7.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi humbet të drejtën e pronësisë mbi kuotën e kapitalit të shitur, si dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i kësaj kuote të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi bëhet pronar, zotëruar me të drejta të plota i kuotës së kapitalit që ai blen sipas kushteve të kësaj Kontrate Shitjes të Kuotave të Kapitalit.
- 7.2 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe të detyrueshme për palët dhe zëvendëson të gjitha dhe çdo kontratë apo marrëveshje të mëparshme me shkrim dhe/ose me gojë midis palëve në lidhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- 7.3 Kjo Kontratë Shitblerjeje hartohet dhe çdo interpretim i saj do të bëhet në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil, ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe dëshirës e vullnetit të palëve për shitblerjen e Kuotave.
- 7.4 Kjo Kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje për palën shitëse dhe dy kopje për palën blerëse dhe një kopje për t'u depozituar në Regjistrin Tregtar QKB.

NENI 8

ANEKSET E KONTRATËS

8.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës; Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:

- Ekstrakt i Regjistrin Tregtar për Shoqërinë Shoqërisë "ISOMETRIC" Sh.p.k, datë 07/12/2023;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;